



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 70

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV NDAJ PERSONIT PËRGJEGJËS TË BASHKISË KUKËS, PËR  
RAPORTIMIN E VEPRIMTARIVE PUBLIKE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES  
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 22 Shkurt 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Z. Defrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike në bashkinë Kukës

**OBJEKT:** Shqyrtim administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kukës, për raportimin e veprimtarive publike

**BAZA LIGJORE:** Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, neneve 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më datë 6.2.2023, në adresën e postës elektronike, të Koordinatorit për të Drejtën e Informimit, ka marrë indicie për organizimin e 1 (një) veprimtarie publike nga ana e bashkia Kukës.

Indicia është marrë nëpërmjet provave ku pretendohet si në vijim:

*“Gjithashtu, theksohet se ky aktivitet nuk është raportuar në ndërfaqen e KQZ-së nga institucioni organizator. Lidhur me këtë veprimtari publike është vetëm link-u që po ju vëmë në dispozicion:*

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 70

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kukës, për raportimin e veprimtarive publike”

<https://www.facebook.com/photo/?fbid=735926821228455&set=pcb.735926974561773>”

Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi paraprakisht çështjen, vlerësoi se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Më datë 9.2.2023, bashkisë Kukës i është kërkuar informacion në lidhje me indicien e marrë, nëpërmjet adresës elektronike.

Më datë 13.2.2023, ora 5:50 PM, bashkia Kukës bën me dije se: *“Në këto aktivitete Kryetari i bashkisë ka qenë i ftuar nga njësisia administrative dhe qendra shëndetësore Bicaq, e cila është në fazën përfundimtare të punimeve. Për shkak të motit të ftohtë është vendosur një orë para që të zhvillohej takimi dhe nuk kishim mundësi që të shtynim datën e pjësmarrjes si të ftuar në këtë aktivitet. Po kështu sic e kemi sqaruar më parë nuk kishim mundësi aksesimi në ndërfaqe sepse nuk kishim kredencialet. Në momentin që na u vendosën në dispozicion kredencialet ne bëmë raportimin e aktiviteteve të tjera.”*

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi u njoh me rrethanat dhe faktet e paraqitura, vlerëson se problematikat me sistemin dhe kredencialet kanë ardhur për shkak të vështirësive në aksesimin e ndërfaqes së raportimeve dhe për shkaqe të tjera objektive jashtë vullnetit të organit publik.

Në këto kushte, duke qenë se qëllimi nuk ka qenë shmangia nga përgjegjësia ligjore e raportimit, vlerësojmë se duhet mirëkuptuar situata e krijuar dhe të pushohet hetimi administrativ për ato shkelje që lidhen me çështjen objekt shqyrtimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, 92 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

#### **V E N D O S:**

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 70

Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kukës, për raportimin e veprimtarive publike”

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj z. Defrim Korbi, person përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, në bashkinë Kukës.
2. Moskonstatimin e shkeljes administrative.
3. Tërheqje vëmendje ndaj bashkisë Kukës, për marrjen e masave të menjëhershme, për raportimin e veprimtarive publike.
4. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**

Data: 22 Shkurt 2023

Nr: 70  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personit përgjegjës të bashkisë Kukës, për raportimin e veprimtarive publike”